



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada – Government*

*Ministria e Forcës së Sigurisë*  
*Ministarstvo Snaga Bezbednosti Ministry of Security Force*  
**Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel**

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me Rregulloren 2001/36 mbi SHCK-në, Urdhëresën Administrative Nr. 2003/2 dhe Udhëzimin Administrativ 2003/01, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës shpall këtë:

**KONKURS**

**Titulli i punës:** Teknik i Makinerisë; FSK 2574

**Mbikëqyrësi:** Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i Njesisë  
**Kohëzgjatja e kontratës:** 36 muaj  
**Niveli i pagës:** A 0  
**Orari:** I plotë  
**Vendi i punës:** **Batalioni i Logjistikës**

**Përshkrimi i punës:** Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si instrument i sigurisë është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë janë; Të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqës. Kjo do të përfshijë operacionet jasht territorit të Republikës së Kosovës, ku do të ftohet për këtë qëllim; të ndihmojë autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore, fatkeqësive dhe emergjencave tjera, madje edhe si pjesë e një përpjekjeje reaguese regjionale apo ndërkombëtare; të kryej shkatërrimin e mjeteve shpërthyes; të ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile. Forca e Sigurisë së Kosovës fillimisht do të përbëhet nga Komanda e Forcave Tokësore, Brigada e Reagimit të Shpejtë, Brigada e Mbështetjes së Operacioneve dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes. Forca e Sigurisë së Kosovës do të përbëhet nga personeli profesional i sigurisë, personeli rezervë, personeli civil dhe rekrutet

Batalioni i Logjistikës përpos stafit të uniformuar do të përbehet edhe nga 4 nëpunës civilë, përgjegjësia e të cilëve të mbështesin dhe ndihmojnë sektorët e ndryshëm brenda KFT-së për realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të ngarkuara. Përgjegjësia e nëpunësit të makinerisë është të kryej detyrat dhe përgjegjësitë sipas mandatit brenda njësisë organizative.

**Qëllimi i postit:**

- Tekniku i makinerisë do të ketë përgjegjësi kryerjen e detyrave të dhëna sipas mandatit.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Të ofrojë mbështetje në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me infrastrukturën në makineri që është në shfrytëzim nga KFT/FSK-ja (p.sh. blerjet, amortizimet, riparimet, kontrollet) për periudhën afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjate.
- Të ndihmojë sipas nevojës, mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe riparimin e të gjithë pajisjeve të lehta dhe të rënda në KFT/FSK.
- Të raportoj rreth gjendjes teknike, dhe përshtatshmërisë së pajisjeve në shfrytëzim,

**Shkathtësitë, përvoja dhe karakteristikat tjera:**

- T'i kryej detyrat e dhëna sipas mandatit dhe ato shtesë brenda periudhës së pranueshme kohore.
- Duhet të përdor maturinë gjatë punës me njerëz dhe detyrën.
- Duhet të jetë i motivuar lartë dhe të ketë etik të fort pune.

- Ai/ajo duhet të jetë në mundësi që të punoj i/e mëvetësishme si dhe të punoj si ekip me punonjës të tjerë në përmbushjen e detyrave të dhëna.

**Kualifikimet e nevojshme:**

- Përgatitja e mesme shkollore (e domosdoshme)
- Përvojë pune në fushën përkatëse .
- Njohja e gjuhës e gjuhës shqipe apo serbe, e dëshirueshme gjuha angleze.

**Kualifikimet e dëshiruara:**

Përvojë të gjatë pune në ndonjë institucion publik apo privat për më tepër se 5 vite.

**Si të aplikoni:** Formularët për aplikim janë në dispozicion në Departamentin e Personelit të M-FSK-së, apo në web-faqen e M-FSK-së, [www.mksf-ks.org](http://www.mksf-ks.org) ,apo [www.ks-gov.net/mfsk](http://www.ks-gov.net/mfsk) ku gjendet shpallja e konkursit. Formularët duhet t'i dorëzohen Departamentit të Personelit personalisht, apo të dërgohen me postë në këtë adresë: **Ministria e FSK-së, Lagja Emshiri 1, 10000 Prishtinë, Departamenti Personelit, Kati II, (Ish-ndërtesa e Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së)**, Prishtinë, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të nevojshme. **Numrat kontaktues:** Për informata plotësuese, mund të thirrni në numrin telefonik kontaktues nr.: 038 200 13 508. Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes së parë në të përditshmet kosovare. Data e fundit e aplikimit është 20.08.2010 Edhe aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, do të konsiderohen valide. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet e tij/saj. Kjo pozitë i nënshtrohet procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të procesit të verifikimit. Për shkak të numrit të madh aplikacioneve, vetëm kandidatët e përzgjedhur dhe të shënuar në listën e shkurtë do të njoftohen. Kandidatët e ftuar në intervistë duhet t'i sjellin kopjet origjinale të dokumenteve të dorëzuara për rishikim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

**Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës iu shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacione të femrave dhe meshkujve, pa dallim nga përkatësia e tyre etnike.**